

AKT THEMELIMI DHE STATUTI I SHOQËRISË

"AIDI" SHPK

Tiranë, sot më 25 / 05 / 2023, unë TEODOR MADHI, i biri i Lefter dhe Tefta, shtetas shqiptar, lindur dhe banues në Tiranë në adresën: Rr. Mihal Grameno, P. 35, Shk.1, Ap 9, identifikuar me letërnjoftimin me Nr Personal F306260600, lëshuar nga MPB më 25.02.2015 me skadencë në 24.02.2025, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, deklaroj me vullnet të lirë, të plotë e të ndershëm dhe iniciativë të lirë private, bazuar të Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Kodin Civil në fuqi, në ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", në ligjin nr. 9723, datë 05.03.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", në Kodin Doganor, në ligjin Tatimor dhe Fiskal, hartoj statutin e shoqërisë "AIDI" SHPK.

KAPITULLI I

Neni 1- Themelimi

Shoqëria "AIDI" SHPK, është person juridik sipas ligjit shqiptar, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (në tekstin e mëtejshëm "Shoqëria").

Neni 2 – Personaliteti juridik

Shoqëria e fiton personalitetin juridik me regjistrimin e saj në organet kompetente, në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara me ligj.

Shoqëria "AIDI" Shpk, është një shoqëri tregtare, e themeluar nga Teodor Madhi, lindur dhe banues në TIRANË (Shqipëri) adresën: Rr. Mihal Grameno, P. 35, Shk.1, Ap 9, identifikuar me letërnjoftimin me Nr Personal F306260600, i cili nuk përgjigjet për detyrimet e Shoqërisë Tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e palikuiduar të kontributeve të nënshkruara. Kontributet e ortakut përbëjnë kapitalin themeltar të regjistruar.

Secili ortak gëzon pjesën e tij në Shoqëri në përpjesëtim me kontributin e dhënë në kapitalin themeltar të Shoqërisë.

Neni 3 – Selia

AIDI shpk ka selinë e saj në adresën: Rruga Pjetër Budi, Nr. 59, H. 1, Ap. Nr. 8, Tiranë, Shqipëri .

Shoqëria mund të ndryshojë selinë, të hapë degë, zyra dytësore, të krijojë filiale në territorin e Republikës së Shqipërisë ose jashtë saj, vetëm me vendim të të gjithë ortakëve.

Neni 4 – Objekti i veprimtarisë

Objekti i kompanisë janë aktivitetet e mëposhtme:

- Menaxhimi e praktikave të autorizimit, zhvillimit, planifikimit, ndërtimit, edhe për llogari të palëve të treta, të impianteve për prodhimin e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme;
- Shitja dhe blerja e impianteve të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme dhe shërbimet e ndërmjetësimit, të prokurimit dhe të përzgjedhjes për impiantet dhe shoqëritë e kualifikuara në ndërtimin e tyre;

- Shërbime të mirëmbajtjes së zakonshme dhe të jashtëzakonshme të impianteve për prodhimin e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme;
- Shërbimet e eficiencës së energjisë, ndërmjetësimi i këtyre impianteve dhe çdo kreditim fiskal dhe kontribut që rrjedh nga ky aktivitet.

Për arritjen sa më të mirë të objektit social dhe me kusht që ai të jetë i dobishëm për realizimin e tij, Shoqëria mund të kryejë të gjitha aktivitetet e tjera tregtare, industriale, financiare, të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme që janë instrumentale, ndihmëse, të lidhura, të nevojshme ose të dobishme, për realizimin e veprimtarive që përbëjnë qëllimin e objektit social, për të fituar interesa dhe aksione në shoqëri ose sipërmarrje të tjera që kanë si objekt veprimtari të ngjashme, ose të lidhura me të tyren, drejtpërdrejt dhe tërthorazi, në Shqipëri dhe jashtë saj, si dhe të lëshoj garanci në favor të të tretëve.

Neni 5- Kohëzgjatja

Shoqëria do të vazhdojë aktivitetin e saj për një periudhë të palimituar.

KAPITULLI II- KAPITALI

Neni 6- Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 000 lekë. Kapitali i sipërpërmendur është nënshkruar nga "ortaku i vetëm" Teodor Madhi, pronar i një (një) kuote me vlerë nominale 100 000 lekë, që përbën në total 100% të kapitalit të Shoqërisë. Kuotat e kapitalit të shoqërisë nuk mund të përfaqësohen me letra me vlerë të negociueshme.

Kontributi i ortakut paguhet në para.

Ortaku përgjigjet ndaj palëve të treta për humbjet e shoqërisë ekskluzivisht për vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Neni 7- Rritja dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i Shoqërisë mund të rritet me nënshkrimin e pjesëmarrjes në kapital nëpërmjet kontributeve në para dhe në natyrë, në varësi të vendimeve të marra nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve.

Zvogëlimi dhe rritja e kapitalit mund të bëhet ekskluzivisht me vendim të të gjithë Ortakëve që figurojnë të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) në momentin e marrjes së vendimit, ashtu sikurse është parashikuar për të gjitha vendimet që ndryshojnë statutin.

Neni 8 Kuotat

Kuotat e kapitalit të Shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin mund të blihen ose transferohen nëpërmjet:

- a) Pagesës, në vijim të rritjes së Kapitalit të Shoqërisë;
- b) Shit-blerjes;
- c) Trashëgimisë për shkak të vdekjes;

Në rast të transferimit të kuotave me kontratë midis personave të gjallë, kontrata duhet të hartohet me shkrim. Ortaku mund të japë prokurë për të shitur kuotat e tij, me kusht që ato të jenë të përpiluara me nënshkrim autentik pranë noterit.

Personi që transferon një kuotë dhe një person tjetër të cilit i kalon kuota, përgjigjen solidarisht dhe individualisht për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, deri në momentin e regjistrimit të transferimit të kuotës në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

KAPITULLI III

ORGANET E DREJTUESE DHE VENDIMMARRËSE

Neni 9 Organi vendimmarrës

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i Shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i Shoqërisë, i cili miraton çdo modifikim të mundshëm të statutit sipas procedurave të përcaktuara me ligj dhe në çdo rast gjithmonë dhe vetëm me pëlqimin e të gjithë ortakëve të regjistruar si të tillë në Shoqëri pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. (QKB). Çdo ndryshim në statut, në mënyrë që të jetë i zbatueshëm ndaj palëve të treta, duhet të depozitohet në QKB.

Mbledhja e Ortakëve ("Asambleja e Përgjithshme") merr vendime me votën e favorshme të shumicës së ortakëve që përfaqësojnë shumicën e kapitalit të shoqërisë për temat e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave dhe investimeve të Shoqërisë;
- b) miratimin e bilanceve vjetore;
- c) shpërndarjen e fitimeve dhe mbulimin e humbjeve;
- d) emërimin dhe revokimin e drejtorit ose drejtorëve të vetëm;
- e) emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar;
- f) punësimin e punonjësve;
- g) përcaktimin e pagave;
- h) themelimin e shoqërive të reja, blerja kuotash në shoqëri të tjera dhe shitja e kuotave në shoqëritë që merr pjesë;
- i) marrja e kredive bankare ose financime nga palë të treta, dhënia e financimeve, vendosja e garancive, të dhëna hua edhe nga të tretë në interes të Shoqërisë;
- j) vendimet që përfshijnë shoqërinë me shpenzime për një shumë që tejkalon trefishin e kapitalit themeltar;
- k) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori, duke përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve në lidhje me ecurinë e biznesit;
- l) përfaqësimi i Shoqërisë në Gjykatë dhe në procedura të tjera kundër administratorëve;
- m) miratimin e rregullave procedurale për mbledhjet e Asamblesë së Ortakëve;
- n) vendimet për riorganizimin dhe shpërbërjen e Shoqërisë.

Të gjitha vendimet e tjera të ortakëve që nuk kanë të bëjnë me temat e listuara më sipër mund të merren me votën e favorshme të shumicës së ortakëve që përfaqësojnë shumicën absolute të kapitalit të Shoqërisë.

Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve regjistrohen në Regjistrin e Vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme, të dhënat e të cilit nuk mund të modifikohen ose anulohen. Në veçanti, por pa u kufizuar në, vendimet që kanë të bëjnë me:

- i. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve për ecurinë e aktivitetit;
- ii. shpërndarja e fitimeve vjetore dhe mbulimi i humbjeve;

- iii. investimet që duhen bërë;
- iv. vendimet për riorganizimin dhe shpërbërjen e Shoqërisë

Vendimet që nuk regjistrohen në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme, përveç rastit kur Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve i ratifikon ato me një vendim të regjistruar në regjistrin e vendimeve pasi është dhënë ky vendim. Shoqëria nuk mund të kundërshtojë pavlefshmërinë ndaj një pale të tretë, e cila i ka fituar të drejtat me mirëbesim, përveçse kur Shoqëria provon se pala e tretë ishte në dijeni të pavlefshmërisë, ose në bazë të rrethanave të dukshme, ajo nuk mund të mos ishte në dijeni për të.

Asambleja mund të mbledhet vetëm me praninë e ortakëve në vendin e caktuar në mbledhje dhe në çdo rast në territorin shqiptar. Pjesëmarrja e ortakëve në më shumë se një vend ose të lidhur me instrumente dhe mjete telekomunikacioni nuk lejohet.

Mbledhja mund të thirret me iniciativë të ortakëve individualë ose të organit administrativ me postë, në adresat e komunikuar nga ortakët individualë, ose me e-mail, në adresat e postës elektronike të komunikuar nga ortakët individualë tek organi administrativ. Thirrja e mbledhjes duhet të bëhet brenda 3 ditësh nga data e caktuar e mbledhjes. Thirrja duhet të përmbajë vendin dhe orën e mbledhjes, si dhe rendin e ditës.

Neni 10 Administrimi

Shoqëria drejtohet nga një organ administrativ i cili mund të përbëhet nga një ose më shumë administratorë, të cilët ushtrojnë kompetencat që u janë besuar bashkërisht ose veçmas, sipas vendimeve të marra nga Asambleja e Përgjithshme në momentin e emërimit.

Asambleja e Përgjithshme, me unanimitet të ortakëve, zgjedh sistemin e administrimit dhe në rastin e disa administratorëve cakton numrin, por asnjëherë më shumë se tre, dhe kompetencat përkatëse.

Administratorët mund të jenë edhe jo-ortakë dhe mund të rizgjedhen.

Administratorët kanë të drejtën e rimbursimit të shpenzimeve të bëra për arsye të detyrës së tyre. Në momentin e emërimit ose me një vendim të vlefshëm deri në modifikim, mbledhja e ortakëve mund të caktojë një pagesë për ta. Nëse në momentin e emërimit, organi administrativ nuk i njihet asnjë pagesë, ata, në përputhje me statutin, me pranimin e detyrës pranojnë të jenë administratorë të Shoqërisë pa marrë asnjë pagesë.

Administrator i shoqërisë është Teodor Madhi i identifikuar me letërnjoftimin me Nr Personal F306260600, banues në Rr. Mihal Grameno, P. 35, Shk.1, Ap 9, Tiranë, shtetas shqiptar, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Administratori i shoqërisë caktohet për një afat 5(pesë) vjet nga momenti i regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, me të drejtë rinovimi automatikisht përveçse kur Asambleja e Përgjithshme vendos ndryshe me shkrim. Emërimi i administratorit i prodhon efektet pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Personi i mëposhtëm caktohet Administrator i shoqërisë i cili do të ushtrojë dhe mbajë në mënyrë të veçantë kompetencat e administratorit:

Të dhënat e identifikimit:

Teodor Madhi

Adresa: Rr. Mihal Grameno, P. 35, Shk.1, Ap 9, Tiranë

dhe specimenët e nënshkrimit:



Neni 11 - Kompetencat

Organi Administrativ ka të drejtë dhe detyrim që:

- a) të kryej të gjitha veprimet e menaxhimit të biznesit të Shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, brenda kufijve të kompetencave të parashikuara në këtë statut;
- b) të kryej transaksione që përfshijnë shpenzime, detyrime financiare dhe pagesa në emër të shoqërisë deri në vlerën 300 000 lekë, përtej së cilës do të nevojitet miratimi me shkrim i vendimit të asamblesë së ortakëve që zotërojnë më shumë se 50% të kapitalit r të shoqërisë.
- c) përfaqëson Shoqërinë gjatë aktivitetit të saj;
- d) siguron mirëmbajtjen korrekte dhe të rregullt të regjistrave dhe librave kontabël të Shoqërisë;
- e) përgatit dhe nënshkruan pasqyrat financiare vjetore, pasqyrat financiare të konsoliduara dhe raportin e menaxhimit të Shoqërisë, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve: i paraqet këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
- f) të informojë menjëherë dhe në çdo rast në kohë Asamblenë e Përgjithshme për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarive dhe ekzistencën e Shoqërisë;
- g) kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të Shoqërisë, sipas ligjit për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- h) raporton përpara Asamblesë së Përgjithshme për zbatimin e politikave tregtare dhe të kërkon autorizim për kryerjen e veprimeve që i përkasin Asamblesë së Përgjithshme, si dhe zbatimin e veprimeve specifike me rëndësi të veçantë për funksionimin e Shoqërisë Tregtare;

Organi Administrativ është i detyruar të thërrasë Asamblenë e Përgjithshme, në adresat, përfshirë adresat elektronike, të komunikuar nga ortakët individualë, edhe në rastet kur:

- i. në bazë të pasqyrave financiare vjetore ose të pasqyrave financiare të ndërmjetme, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë të mos mbulojnë detyrimet që mund të kërkohen brenda tre muajve në vijim;
- ii. kur Shoqëria, brenda dy viteve të para të regjistrimit, propozon të blejë nga një ortak, pasuri me vlerë më të madhe se 5 për qind të aktiveve të shoqërisë, siç tregohet në pasqyrat e fundit financiare të audituara.

Administratori ka kompetencën për të kryer të gjitha veprimet e zakonshme dhe të jashtëzakonshme të administrimit, brenda kufijve të kompetencave që i përkasin Asamblesë së Përgjithshme ose Ortakëve në bazë të këtij statuti. Administratori përfaqëson shoqërinë përpara personave fizikë dhe juridikë, publikë dhe/ose privatë, vendas ose të huaj, autoritete shqiptare ose të huaja, përfshirë autoritetet tatimore dhe gjyqësore. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të Shoqërisë, në të gjitha rrethanat, me përjashtim të kompetencave që ligji dhe ky statut i jep shprehimisht Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë.

Organi Administrativ e angazhon Shoqërinë në marrëdhënie me të tretët nëpërmjet akteve që përputhen me objektin e saj dhe me kompetencat e parashikuara në këtë Statut.

Shoqëria nuk angazhohet ndaj palëve të treta nga Organi Administrativ kur palët e treta kanë qenë në dijeni se operacionet, kontratat dhe aktivitetet në përgjithësi të kryera nga Organi Administrativ tejkalojnë objektin e Shoqërisë dhe kompetencat e vetë Organit Administrativ.

Organi Administrativ nuk mund të caktojë përfaqësues ose autorizues për akte të caktuara apo kategori aktesh, pa miratimin e Asamblesë së Përgjithshme.

Në çdo rast, kur përfaqësimi i Shoqërisë i jepet një personi që nuk është Administrator, caktimi i autorizimit të përfaqësimit të Shoqërisë rregullohet nga rregullat e prokurës.

Neni 12- Përgjegjësia

Organi Administrativ dhe/ose administratori përgjigjen individualisht ndaj Shoqërisë dhe të tretëve për shkelje të legjislacionit, për shkelje të statutit ose për shkelje të kryera gjatë administrimit të Shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Asambleja e Përgjithshme, të cilat i shkaktojnë dëm shoqërisë, janë përgjegjësi e administratorit ose administratorët, të cilët kanë lidhur marrëveshjen.

Me përjashtim të rasteve të parashikuara nga dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, të përmendura në nenet 14, 15, 17 dhe 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori është i detyruar:

- a) kryejë funksionet e tij të përcaktuara me ligj dhe nga këto statute në mirëbesim dhe në interesin më të mirë të Shoqërisë, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të aktiviteteve të shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat e njohura nga ligji dhe nga ky statut, vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë, analizojë dhe vendosë me përgjegjësi për çështjet e Shoqërisë;
- d) të parandalojë dhe shmang rasteve të konfliktit, real dhe/ose potencial, të interesave personale me ato të Shoqërisë;
- e) të kryejë funksionet e tij me profesionalizëm dhe me masat e nevojshme.

Organi Administrativ dhe/ose administratori, gjatë ushtrimit të detyrave të tij, i përgjigjen shoqërisë për çdo veprim apo mosveprim që lidhet në mënyrë të arsyeshme me objektivat e shoqërisë, përveç rasteve kur, në përputhje me një hetim dhe vlerësim të informacionit përkatës, veprimi ose mosveprimi bëhet me mirëbesim dhe pa neglizhencë.

Nëse Organi Administrativ dhe/ose administratori vepron në kundërshtim me funksionet dhe shkel standardet profesionale të përmendura në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, i kërkohet që të kompensojë Shoqërinë për dëmet e shkaktuara nga shkelja, si dhe të transferojë në Shoqëri çdo përfitim personal ose që personat e lidhur me të kanë marrë nga këto veprime të pahijshme. Administratori mban barrën e vërtetimit të kryerjes së detyrave të tij në mënyrë të rregullt në përputhje me standardet e kërkuara. Kur shkelja kryhet nga disa Administratorë, ata i përgjigjen bashkërisht Shoqërisë.

Në veçanti, por jo vetëm, Organi Administrativ dhe/ose administratori janë të detyruar të dëmshpërblejnë Shoqërinë për dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", kryejnë këto veprime:

- i. kthejnë kontributet te ortakët;
- ii. të bëjnë pagesa të interesit ose dividendëve te ortakët;
- iii. shpërndarjnë e aktiveve të Shoqërisë;
- iv. lejojnë shoqërinë të vazhdojë aktivitetin tregtar, kur në bazë të situatës financiare duhet të parashikojnë që shoqëria nuk ka aftësi të shlyejë borxhet e saj;
- v. u japin kredi subjekteve që nuk janë të besueshëm.

Neni 13 - Viti financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor.

Neni 14 - Pasqyrat financiare dhe dividendët e shoqërisë

Brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit financiar, Asambleja e Përgjithshme miraton bilancin e paraqitur nga Organi Administrativ.

Asambleja e Përgjithshme vendos për shpërndarjen e dividendëve vetëm pasi të ketë ulur humbjet e viteve të mëparshme financiare, sipas ligjit.

Neni 15 – Ekspertët

Nëse vendoset nga Asambleja e Përgjithshme, me votën e favorshme të shumicës së Ortakëve të regjistruar në QKB, të cilët përfaqësojnë shumicën e kapitalit, shoqëria mund të caktojë një ekspert kontabël me detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël, tregtar dhe ekonomik të Shoqërisë, me kontrole periodike dhe me kontroll vjetor të pasqyrave financiare të përgatitura nga Organi Administrativ.

Në përfundim të çdo kontrolli eksperti kontabël përgatit një raport me shkrim për pasqyrat financiare vjetore dhe për kontrollet periodike të kryera, të cilin i kërkohet t'i paraqesë dhe t'ua dorëzojë ortakëve, duke e depozituar në selinë e Shoqërisë të paktën 30 ditë përpara datës së caktuar për miratimin e bilancit vjetor nga Asambleja e Përgjithshme.

Neni 16 – Shpërndarja e fitimeve

Fitimet neto që mbeten pas krijimit të rezervave të kërkuara me ligj ose nga Asambleja e Përgjithshme dhe pas shpërndarjes së fondeve të nevojshme për likuidimin e çdo detyrimi tatimor ose pagesave ndaj palëve të treta mund t'u shpërndahen ortakëve të shoqërisë, me vendim të marrë në unanimitet nga Ortakët e Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 17 - Shpërbërja

Shpërbërja ose prishja e Shoqërisë mund të kryhet në çdo kohë:

- a) Kur përfundon periudha e kohëzgjatjes së parashikuar në aktin e themelimit;
- b) me vendim, unanimisht të anëtarëve, të Asamblesë së Përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) nëse nuk është ushtruar aktivitet tregtar prej dy vitesh dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë, në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 05.03.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- e) me vendim të Gjykatës.

Në këtë rast, Asambleja e Përgjithshme merr një vendim me shkrim që parashikon likuidimin e shoqërisë, duke caktuar një ose më shumë likuidues dhe duke raportuar në çdo dokument të lëshuar nga shoqëria shënimin shtesë "Shoqëri në proces likuidimi". Në rast të emërimit të disa likuiduesve, përveç rasteve kur Asambleja e Përgjithshme parashikon ndryshe, vendimet e tyre duhet të merren bashkërisht, unanimisht.

Shpërbërja e Shoqërisë sjell si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit, në gjendje aftësie paguese, me përjashtim të rasteve kur kanë filluar procedurat e falimentimit.

Likuidimi kryhet nga likuidues të caktuar nga Asambleja e Përgjithshme.

Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk merr vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve nga vendimi për shpërbërjen, çdo palë e interesuar mund t'i drejtohet gjykatës për caktimin e një likuiduesi.

Neni 18 Likuiduesi

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorit/ve që nga data e emërimit të tij. Me emërimin e likuidatorit, Organi Administrativ pushon së funksionuari.

Nëse shoqëria ka emëruar më shumë se një likuidues, përveç rasteve kur akti i emërimit parashikon që ata veprojnë veçmas nga njëri-tjetri, likuiduesit ushtrojnë të drejtat dhe detyrimet e tyre bashkërisht. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre për të kryer veprime specifike.

Kufijtë e të drejtave të likuiduesve janë të detyrueshëm për të tretët, në përputhje me dispozitat e ligjit. Likuiduesit i nënshtrohen mbikëqyrjes së Ortakëve.

Neni 19 - Të drejtat dhe detyrimet e likuidatorit

1. Detyra e likuiduesve konsiston në përfundimin e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhjen e kredive dhe kontributeve të papaguara nga ortakët, shitjen e aktiveve dhe pagesën e kreditorëve, në përputhje me prioritetet, sipas nenit. 605 të kodit civil.
2. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, ekskluzivisht për mbylljen e punëve të papërfunduara.
3. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit. Likuiduesi përgatit një bilanc shtetëror të shoqërisë në momentin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në momentin e mbylljes së procedurave të tilla. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit edhe llogaritë vjetore të shoqërisë. Buxhetet duhet t'i paraqiten Asamblesë së Përgjithshme për miratim.

Neni 20 - Mbyllja e Likuidimit

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me seksionin V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Neni 21 - Bashkimi

Dy ose më shumë shoqëri mund të bashkohen nëpërmjet:

1. Kalimit të të gjitha aktiveve e pasiveve të njëres ose më shumë prej shoqërive, që quhen shoqëritë e përthithura, të një shoqëri tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëria përthithëse, në këmbim të aksioneve apo kuotave të kësaj shoqërie. Ky proces quhet bashkim me përthithje.
2. Themelimit të një shoqërie të re, tek e cila kalohen të gjitha aktivet e pasivet e shoqërive ekzistuese, që bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë së re. Ky proces quhet bashkim me krijim i një shoqërie të re.

Të gjitha operacionet e bashkimit që përfshijnë Shoqërinë duhet të miratohen unanimitisht nga Asambleja e Përgjithshme e ortakëve.

Neni 22 – Ndarja

Një shoqëri mund të ndahet me vendim të asamblesë së përgjithshme, duke transferuar të gjitha aktivet e pasivet e veta në favor të dy ose me shumë shoqërive ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet, vlerësohet e prishur.

Për ndarjen e shoqërisë zbatohen përkatësisht dispozitat e neneve 216 deri në 225 të ligjit të ligjit 9901 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

Shoqëritë, që fitojnë pasuritë e shoqërisë që ndahet, quhen shoqëri pritëse dhe përgjigjen në mënyrë solidare për detyrimet e kësaj të fundit.

Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit ka si pasojë:

a) kalimin të shoqëritë pritëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që ndahet, në përputhje me raportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja për marrëdhëniet ndërmjet shoqërive, si dhe për palët e treta;

b) bërjen e aksionarëve/ortakëve të shoqërisë që ndahet aksionarë apo ortakë të një ose më shumë shoqërive pritëse, në përputhje me raportin e ndarjes, përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes;

c) vlerësimin e shoqërisë që ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, sipas seksionit V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” pa kryerjen e likuidimit.

Të gjitha operacionet e ndarjes që përfshijnë Shoqërinë duhet të miratohen unanimisht nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve.

Neni 23 - Transformimi

Shoqëria mund të ndryshojë formën e saj ligjore, nëpërmjet shndërrimit të saj në shoqëri aksionare. Transformimi nuk ka pasoja mbi të drejtat dhe detyrimet që shoqëria ka marrë ndaj të tretëve.

Të gjitha operacionet e ndarjes që përfshijnë Shoqërinë duhet të miratohen unanimisht nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve.

Neni 24 - Baza ligjore

Shoqëria do të kryejë aktivitetet e saj në përputhje me dispozitat e këtij statuti dhe legjislacionit shqiptar.

Për çdo gjë që nuk parashikohet në këtë statut zbatohen dispozitat e ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Kodit Civil dhe çdo ligji tjetër specifik të Republikës së Shqipërisë.

Neni 25 – Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin ose interpretimin e këtij statuti ose për çdo mosmarrëveshje ndërmjet Shoqërisë dhe palëve të treta, juridiksion do të jetë Gjykata Shqiptare e vendndodhjes së Shoqërisë.

Neni 26 - Dispozitat përfundimtare

Ky statut është hartuar në 4 (katër) kopje të së njëjtës vlerë juridike në gjuhën shqipe dhe është nënshkruar me vullnetin e plotë të ortakut themelues.

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"AIDI"

TEODOR MADHI

